



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:127477

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06788794

Pml.nr.22/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Valdete Daka, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Afrim Shala, anëtar, me bashkëpunëtoren profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit ... “...” ... personit përgjegjës K. Th., për shkak të veprës penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me par.3 dhe 7 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të pandehurit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, P.nr.160/2023 të datës 11.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.834/2024 të datës 29.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 28 janar 2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hudhet si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit ... “...” ... personit përgjegjës K. Th. e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Kamenicë, P.nr.160/2023 të datës 11.04.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PN.nr.834/2024 të datës 29.05.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, me aktvendimin P.nr.160/2023 të datës 11.04.2024, ka refuzuar kërkesën për hudhjen e aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP/II.nr.865/2023 të datës 28.12.2023, të parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit, për veprën penale asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës nga neni 358 par.2 lidhur me par.3 dhe 7 të KPRK-së.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktvendimin PN.nr.834/2024 të datës 29.05.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit, avokati Muharrem Kurtaj nga P., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë këtë kërkesë dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.10/2025 e datës 23.01.2025, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit të hudhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 par.1 dhe par.2 të KPPK, i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, sipas dispozitës së nenit 432 par.1 të KPPK, mund të ushtrohet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë.

Në rastin konkret, siç rezulton nga shkresat e çështjes, procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë, ajo ndodhet në fazën e ngritjes së aktakuzës dhe kundërshtimit të provave të parapara sipas kapitulli XVI të KPP-së, pra shqyrtimi gjyqësor akoma nuk ka filluar dhe

procedura nuk ka përfunduar në këtë çështje pasi që e njëjta do të vazhdojë sipas kapitullit XIX të KPP-së, prandaj kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, në këtë rast nuk është e lejuar.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 435 par.2 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.22/2025, më datë 28 janar 2025.

Bashkëpunëtoreshë profesionale,
Qefsere Berisha

Kryetarja e kolegjit,
Valdete Daka